

## NJË PËRPPJEKJE PËR PËRVIJIMIN E RILINDASIT SHQIPTAR ALUSH SARAÇI NDËRMJET VITEVE 1895-1909

Heral A. SARAÇI, Avokat, Tiranë  
e-mail: hsaraci@yahoo.com

### Abstrakt

Ky punim synon të ndriçojë kontributin e Alush Saraçit në zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Duke u mbështetur në burime arkivore dhe referenca të historisë sonë arsimore, autori evidenton rolin kyç të Saraçit në krijimin e Komisionit Arsimor të Sanxhakut të Elbasanit, si dhe përpjekjet e tij për institucionalizimin e mësimi të gjuhës shqipe në kushte të vështira politike e sociale. Teksti trajton gjithashtu marrëdhëniet e tij me figura të njohura rilindëse si Kostandin Kristoforidhi, pjesëmarrjen e tij në organizime kombëtare si dhe ndikimin që pati në themelimin e Shkollës Normale të Elbasanit.

*Fjalë kyç:* Rilindja Kombëtare, Alush Saraçi, arsim kombëtar, Elbasani, gjuha shqipe, Komisioni Arsimor, Shkolla Normale.

### An attempt to trace the Albanian Renaissance Figure Alush Saraçi between 1895–1909

### Abstract

This paper aims to shed light on the contribution of Alush Saraçi to the development of national education in Albania at the end of the 19th century and the beginning of the 20th century. Drawing on archival sources and educational historiography, the author highlights Saraçi's key role in the establishment of the Educational Commission of the Elbasan Sanjak and his efforts to institutionalize the teaching of the Albanian language under difficult political and social conditions. The text also examines his relationship with prominent Renaissance figures such as Kostandin Kristoforidhi, his involvement in national organizing efforts, and his influence on the founding of the Elbasan Normal School.

*Keywords:* Albanian National Renaissance, Alush Saraçi, national education, Elbasan, Albanian language, Educational Commission, Normal School.

## Hyrje

Kontributi i Elbasanit në Rilindjen Kombëtare është i lidhur ngushtë me figura të tilla si Kostandin Kristoforidhi, Kongresi i Elbasanit dhe Shkolla Normale e qytetit. Një fakt i rëndësishëm, por shpesh i neglizhuar, është ekzistenca dhe roli i Komisionit Arsimor të Sanxhikut të Elbasanit, i themeluar dhe drejtuar nga mësuesi dhe juristi Alush Saraçi (1856-1915) në vitin 1901 (Shkodra, 1984: 85), por që nuk pasqyrohet në librat tanë të historisë. Ai ishte shok ideali me rilindasin Kostandin Kristoforidhi dhe nxënës tij.<sup>274</sup> Alushi, një personalitet historik elbasanas, dokumentohet në foton e Kongresit të Elbasanit (1909), edhe pse nuk përmendet si pjesëmarrës në këtë veprimtari kombëtare<sup>275</sup>.

Para vitit 1909, Alush Saraçi ishte mësimdhënësi me autoritetin administrativ më të lartë në prefekturën e Elbasanit. Prandaj, puna dhe vepra e tij janë rruga për të kuptuar zhvillimin e arsimit kombëtar ndërmjet viteve 1895-1909 në Elbasan e më gjerë. Është përpjekja e Alush Saraçit me shokë atdhetarë që pavarësisht sundimit osman, paragjykimeve fetare dhe ngatërresave feudale, arrijnë që në Elbasan e në fshatra, në Manastir e në Stamboll të krijojnë një veprimtari arsimore mbi të cilën do të zhvilloheshin ngjarjet e rëndësishme kulturore kombëtare që u organizuan pas shpalljes së Hyrjetit në viset shqiptare. Rrjedhimisht, mosvlerësimi i kontributit të Komisionit Arsimor të Sanxhikut të Elbasanit me në krye patriotin Alush Saraçi është jo vetëm një mangësi në kronologjinë e ngjarjeve por edhe fshehje e së vërtetës historike. Rritja e personalitetit të tij historik është pasqyrë e zhvillimit të lëvizjes kombëtare shqiptare, ndërsa themelimi i Komisionit Arsimor ishte rrjedhojë logjike e ngjarjeve arsimore të ndodhura në Prefekturën e Elbasanit.

## Figura e Alush Saraçi

Në fund të vitit 1896, krahina e Shpatit i drejtoi një kërkesë fuqive të mëdha në gjuhën frënge, duke kërkuar që të ushtrohej ndikim mbi Portën e Lartë për të marrë "lejen zyrtare për të patur shkolla shqipe në krahinën tonë". Ky dokument nuk përfaqësonte thjesht një provë të vetëdijes kombëtare të hartuesve, por ishte gjithashtu dëshmi e ngritjes së lëvizjes kombëtare shqiptare në një nivel më të lartë organizativ (Myzyri, 2004: 143).

Mithat Frashëri, në një letër nga Stambolli drejtuar Pandeli Evangjelit në vitin 1897, flet për një atdhetar që kishte ardhur në Stamboll nga viset e perëndishme dhe thotë se "puna e gjuhës është hapur në çdo anë dhe bota veç për vivlla (libra) e kanë keq në Elbasan, në Berat, në Dibër dhe në Manastir po qajnë me lot".<sup>276</sup> Pikërisht në këto vite provohet pjesëmarrja e Alush Saraçit sa në Manastir e në Stamboll, në kurset e ndryshme për gradat e nëpunësit zbatues të drejtësisë (1896)<sup>277</sup> dhe kryesekretarit të gjykatës (1897).<sup>278</sup>

Një ngjarje interesante e kësaj kohe për historinë e arsimit shqip është futja për dy vjet (1897-1899) e mësimi të lëndës së gjuhës shqipe në shkollën vllahe të qytetit të Elbasanit (Myzyri, 1973: 168). Ishte ky një sukses i pjesshëm i përpjekjeve për zyrtarizimin e gjuhës shqipe në sistemin arsimor të perandorisë osmane e njëkohësisht provë e rreptësisë së pushtetit për të mos lejuar asnjë shteg mësimi kombëtar. Konsulli rus i Manastirit i asaj kohe raportonte për një lëvizje të organizuar kombëtare dhe të drejtuar nga udhëheqës në Elbasan (Myzyri, 2004: 149). Këto ngjarje arsimore kombëtare e të tjera

<sup>274</sup> H. Myzyri, "Shkollat e Para Kombëtare Shqipe", f. 146.

<sup>275</sup> Histori e Shqiptarëve gjatë Shekullit XX, Vëll. 1, QSA IH, Tiranë, 2017, f. 96.

<sup>276</sup> Histori e Shqiptarëve gjatë Shekullit XX, Vëll. 1, QSA IH, Tiranë, 2017, f. 144.

<sup>277</sup> Dëshmi e Ministrisë së Drejtësisë në Stamboll.

<sup>278</sup> M. Peza, Zh. Kadilli, F. Stafa "Alush Saraçi veprimtar i Rilindjes Kombëtare", BSH Univ. Aleksandër Xhuvani, viti XXII i botimit 2021/1 (47), f. 90.

formësojnë Komisionin Arsimor të Sanxhakut të Elbasanit në vitin 1901. Ai ishte një institucion zyrtar i cili nuk finançohej nga buxheti i shtetit osman.

Dokumentohet se gjatë veprimtarisë në krye të këtij institucioni, në sanxhakun e Elbasanit, Alush Saraçi ka kontribuar "në hapjen e shkollës ruzhdije të vajzave dhe të disa shkollave idadije në Elbasan, si edhe në rihapjen e 23 shkollave iptidaije (fillore) në qytetin dhe trevën e Elbasanit"<sup>279</sup>. Nga një këndvështrim i ngushtë nacionalist, ky fakt mund të tingëllojë kontradiktor, por është tregues i një pune këmbëngulëse për ngritjen e një strukture arsimore, me synim sigurimin e ndërveprimit ndërmjet nxënësit shqiptar dhe mësuesit osman. Meqenëse në shumicën e rasteve mësuesi dhe nxënësi ishin shqiptarë, realisht krijohej mundësia për mësimin shqip jozyrtar. Kjo veprimtari pioniere e Kryetarit të Komisionit është në koherencë të plotë edhe me aspiratën Rilindësve të Sami Frashërit "... të hapimë shkolla, të mësojmë, të mos mbesë ndonjë shqiptar i paditur..." (Frashëri, 1899: 97). Në lidhje me këtë, realiteti i Elbasanit në fillim-shekullin XX ishte shembull i masivizimit të mësimin të gjuhës shqipe.

Duhet shënuar se në këto vite Alush Saraçi ishte dhe Kryetar i Bashkisë së Elbasanit. Megjithëse kryente dy detyra njëkohësisht, ai ofiqet nuk i kishte dekoratë. Detyrën e Drejtorit të Arsimit të Prefekturës Alushi e kryente pa pagesë, sepse edukimin e bashkëkombësve e shihte si mision dhe nder. Alushi ka shkuar vetë me kalë në fshatrat e Elbasanit për të themeluar shkollat e reja e për të ndjekur mbarëvajtjen e mësimdhënies.

## Konkluzione

Alush Saraçi nuk ishte thjesht mësues, por një edukator iluminist. Për zhvillimin e kësaj veprimtarie kulturore kërkoheshin jo vetëm njohuri të sistemit administrativ osman, por edhe urtësi dhe vendosmëri, të cilat shkriheshin natyrshëm në personalitetin fisnik të Alush Saraçit. Ai me përvojën në punë në funksione të ndryshme, i kishte të gjitha kompetencat profesionale juridike për të vlerësuar kushtet në të cilat zhvillohej lëvizja arsimore në Elbasan dhe më gjerë. Alush Saraçi ishte një figurë publike e qytetit me të cilin qytetarët këshilloheshin për problemet e hasura dhe e respektonin si Rushdi-Dijetar; zotëronte gjuhët e lindjes dhe frëngjishten.<sup>280</sup> Largpamësia e punës së Alush Saraçit u vërtetua me mundësitë e reja që u shfaqën menjëherë pas shpalljes së Hyrjetit në Perandorinë Osmane, më 23-24 Korrik 1908. Më 2 gusht 1908 në Elbasan themelohet shkolla fillore shqipe e qytetit (Myzyri, 2004: 164). Alushit i takon merita e themelimit, si dhe e përfshirjes së mësimin të gjuhës shqipe në vijim në shkollat osmane të qytetit.

Komisioni Arsimor përbënte një përpjekje të strukturuar për zhvillimin e arsimit shqip nën sundimin osman. Në këtë kuadër, Saraçi kontribuoi në hapjen e shkollave ruzhdije dhe iptidaije në qytet dhe fshatra, si dhe futjen e gjuhës shqipe në shkolla vllahe (Peza, Kadilli & Stafa, 2021). Këto përpjekje ishin të harmonizuara me vizionin e Sami Frashërit për edukimin masiv të shqiptarëve (Frashëri, 1899).

Më 31 Dhjetor 1908, nga Elbasani i drejtohet parlamentit osman kërkesa telegrafike për njohjen e kombësisë shqiptare.<sup>281</sup> Ai është ideatori i kësaj kërkesë në kuadër të klubit "Bashkimi" të qytetit. Alush Saraçi është autoriteti arsimor që në verën e vitit 1909 teston në provim katër kandidatë dhe i licencon mësues shëtitës të fshatrave të Shpatit (Myzyri, 1967: 43).

<sup>279</sup> M. Peza, Zh. Kadilli, F. Stafa "Alush Saraçi veprimtar i Rilindjes Kombëtare", BSH Univ. Aleksandër Xhuvani, viti XXII i botimit 2021/1 (47), f. 92.

<sup>280</sup> AQSH, Prefektura e Elbasanit, F. 145, dok. nr. 14 833 (dt. 29 Janar 329), nr. 14 134 (dt. 30 Janar 329), nr. 14 194 (dt. 2 Shkurt 329).

<sup>281</sup> Historia e Popullit Shqiptar, v. 2, ASHSH IH, 2002, f. 402.

Pikërisht kur puna e tij arsimore do të ishte pjesë e natyrshme e organizimeve kombëtare, Kongresit dhe Shkollës Normale të Elbasanit ai u godit nga regjimi osman, duke u larguar nga administrata në pension të parakohshëm. Në këtë kohë ishte mësues i osmanishtes i shkollës vllahe të Shën Kollit në Elbasan. Në kulmin e pjekurisë intelektuale, ai vazhdoi të kontribuonte si nacionalist shqiptar si për organizimin e Kongresit, ashtu edhe për themelimin e Shkollës Normale të Elbasanit. Në foton e Kongresit të Elbasanit ai qëndron në ballkonin e historisë së bashku me Mit’hat Frashërin.<sup>282</sup> Disa muaj më vonë, në përfundim të vitit të parë të Shkollës Normale, u banë “Provimet e botëshme të Mësimoreve Normale dhe të dhanunit e çmimevet” e Drejtori Luigj Gurakuqi mbajti një ligjëratë. Në sallën e madhe të Shkollës Normale ndodheshin parësia e Elbasanit me Kryetarin e Bashkisë, Alush Saraçi.<sup>283</sup>

## Referenca

- Frashëri, S. (1899). *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë?*. Bukuresht.
- Instituti i Historisë. (2017). *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX* (Vëll. 1). Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Myzyri, H. (1973). *Shkollat e para kombëtare shqip*. Tiranë.
- Myzyri, H. (2004). *Shkolla Normale e Elbasanit*. Tiranë.
- Peza, M., Kadilli, Zh., & Stafa, F. (2021). Alush Saraçi – veprimtar i Rilindjes Kombëtare. *Buletini Shkencor i Universitetit 'Aleksandër Xhuvani'*, 22(1), 90–92.
- Sinani, A. (2024, June 6). *Kongresi i Manastirit - 116 vite nga alfabeti që na bashkoi: Dokumente arkivore, artikuj dhe fotografi*. Monografi Akademike Shqiptare.
- Shkodra, Z. (1984). *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*. Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

<sup>282</sup> Histori e Shqiptarëve gjatë Shekullit XX, Vëll. 1, QSA IH, Tiranë, 2017, f. 96.

<sup>283</sup> Gazeta Tomorri, E mërkurë 30 Qershor 1910-1326, f. 1.